**ANA LALAJ**

# DETANTA E PARË DHE SHQIPËRIA*

Më 5 mars 1953 Stalini vdiq. Enver Hoxha nxori në qendër të Tiranës mijëra shqiptarë që ranë në gjunjë përpara përmendores së bronztë të Stalinit dhe u betuan se do të ndiqnin me besnikëri mësimet e tij. Më vonë, një telegram i nënshkruar me 749 440 firma[1] iu dërgua udhëheqjes komuniste sovjetike në Moskë.

Vdekja e Stalinit u bë pikënisje për një varg ndryshimesh në BS dhe në vetë bllokun komunist. Figurat e reja që erdhën në udhëheqjen më të lartë komuniste sovjetike, ndër të cilët Hrushovi ishte më i avancuari, jo vetëm që nuk u pajtuan me mënyrën e qeverisjes me grusht të hekurt të Stalinit, por u përpoqën të rrëzojnë barrierat që ai kishte lënë pas, madje së fundi të çmontojnë edhe vetë kultin e tij. Drejtuesit e rinj të PKBS shpallën menjëherë *Kursin e Ri* në politikën e brendshme dhe të jashtme të BS, që në histori ka hyrë me emrin kursi i destalinizimit. Kursi i Ri u karakterizua nga bashkekzistenca paqësore me Perëndimin, nga afrimi me Jugosllavinë, vendet neutrale dhe vendet e Botës së III, nga likuidimi i terrorit masiv stalinist brenda BS dhe demaskimi i vetë figurës së Stalinit.

Në vijim të këtij kursi, Hrushovi u angazhua në një proces intensiv dialogimi me ShBA, për shumë probleme që kishin mbetur pezull që nga mbarimi i Luftës Dytë Botërore. Përkundër politikës ekspansioniste territoriale sovjetike, Hrushovi ndoqi rrugën e koncesioneve ndaj Perëndimit. Sipas tij koha e Leninit kishte kaluar dhe "një politikë e hapur agresive ndaj ShBA dhe aleatëve të saj, si ajo që ndoqi Stalini më 1948-49, vetëm do të çimentonte aleancat antisovjetike dhe do të çonte në riarmatosjen e rritur të Perëndimit"[2]. Nuk përjashtohet që zotërimi i bombës me hidrogjen në gusht 1953, t'i ketë dhënë sovjetikëve siguri për një balancim ushtarak me amerikanët dhe mundësi për një vlerësim më realist të rolit të armëve konvencionale dhe shtytje në kërkim të rrugëve të reja për marrëdhënie normale ndërkombëtare.

---

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën e Tretë të Institutit të Albshkencës, Tiranë, 2007.

[1] *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë / Arkivi i Partisë* (më tej: *AQSh/AP*), Marrëdhëniet e PPSh-PKBS, Fondi 14, viti 1953, dos. 2.

[2] J.A.S.Grenville, *A History of the World from the 20th to the 21st century,* Routledge, London and New York: 2005, f. 471.

ShBA dhe Perëndimi që ishin angazhuar në sigurimin e mirëqenies dhe internacionalizmin e shumë problemeve, u treguan të gatshëm për të kapur shansin që paraqiste Hrushovi për një shtendosje të marrëdhënieve të ngrira prej vitesh. Nga bashkëbisedimet e frytshme BS-ShBA, në vitet 1953-1958, në marrëdhëniet Lindje –Perëndim filloi një periudhë tërësisht e re në historinë e Luftës së Ftohtë, që njihet me emrin "Detanta e Parë", ose "Shkrirja e Akujve". Shfaqet e dukshme të Detantës së Parë janë një varg traktatesh paqeje të nënshkruara me vendet e Evropës dhe të Azisë, shpërndarja e Kominformit, pranimi i 16 vendeve në OKB, mbledhja e Gjenevës, me pjesëmarrjen e kryeministrave të BS, SHBA, Britanisë dhe Francës, që dhanë mesazhin e reduktimit të tensioneve politike ndërkombëtare etj. Koncesionet që BS i bëri Perëndimit dhanë frytet e tyre.

Pas këtyre shfaqjeve të shumta të Detantës Parë, u duk sikur Lufta e Ftohtë kishte përfunduar. Por ishin vendet e Bllokut komunist me revoltat e tyre spektakolare dhe me një varg ndryshimesh politike, që i kujtuan botës se Lufta e Ftohtë vazhdonte dhe Detanta ishte vetëm një shkrirje e pjesshme e akujve.

Hrushovi, ashtu si Stalini, i konsideronte këto vende si trashëgimia e ligjshme dhe më me vlerë e Luftës Dytë Botërore. Ai nuk lejoi të prekej kjo trashëgimi. Përkundrazi mori një varg masash që ta bënte komunizmin të funksionojë në këto vende duke u siguruar popujve të tyre një jetë më të mirë. Ai u përpoq që të godiste "stalinët e vegjël" dhe makinën shtypëse shtetërore që ata kishin në përdorim. Është kjo arsyeja që vetëm disa javë pas vdekjes së Stalinit, udhëheqësit sovjetikë dhanë mesazhin e një procesi ndryshimesh që duhej të ndodhnin në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. Informacioni që sovjetikët kishin nga ambasadat e tyre, nga këshilltarët e atashuar në institucionet më të larta shtetërore dhe partiake të këtyre vendeve, si dhe nga shumë kanale të tjera, bënin me dije se situata ishte shpërthyese në të gjithë Bllokun. Ata thirrën me shpejtësi në Moskë drejtuesit kryesorë komunistë të Hungarisë, Rumanisë, Çekosllovakisë, Polonisë dhe Bullgarisë, të cilëve u deklaruan hapur se "një katastrofë do të ndodhë nëse ne nuk përmirësojmë këtë situatë".[3] Më 20 qershor 1953, do të thirrej në Moskë edhe E. Hoxha, i cili do të kritikohej ashpër për zbukurim të situatës në Shqipëri, për mosrealizim të planeve ekonomike, për aparatin shtetëror të fryrë sa as Rrokfeleri dhe Morgani nuk do të guxonin ta mbanin, për fshatarësinë që ishte e pakënaqur pasi rronte në mizerabilitet dhe nuk siguronte dot as bukën e gojës, për punëtorët që paguheshin keq dhe për ushtrinë që ishte jo e besueshme etj. Enver Hoxhës iu dha ultimatumi se ishte i "ngarkuar me shumë funksione" dhe se

[3] Janosh Rainer, "The New Course in Hungary in 1953", në: *Cold War International History Project*, Working Paper, Washington D.C.: no. 17.

duhej "të shkarkohej"[4] duke shpërndarë përgjegjësitë ndër shokë të tjerë. Pas kësaj mbledhje dhe pas një letre të ashpër të dërguar në tetor të po atij viti, në institucionet qendrore shqiptare u bënë shumë shkurtime; ndërtimi i veprave të mëdha industriale u anulua dhe fondet e investimeve të parashikuara për to kaluan për mallra të konsumit të popullsisë; u ndryshuan prioritetet e zhvillimit të ekonomisë, duke përcaktuar si degë më të rëndësishme bujqësinë etj.

I ndërvarur plotësisht nga mbështetja ekonomike dhe politike sovjetike, E. Hoxha veproi me shpejtësi dhe demonstroi një qëndrim autokritik të fuqishëm për të vënë në jetë detyrat e sovjetikëve. Madje kërkoi dhe gjashtë këshilltarë sovjetikë për ndihmë. Si përfundim, një vit më vonë, në qershor 1954, ai u thirr përsëri në Moskë, ku i njoftuan se kishin vendosur që ai të ishte sekretar i parë dhe Mehmet Shehu, kryeministër. Një muaj më pas, në Plenumin e KQ më 12 korrik, sipas vendimeve të Moskës, Enver Hoxha la postin e kryeministrit, të ministrit të jashtëm, të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, duke mbajtur vetëm funksionin e Sekretarit të Parë dhe atë të kryetarit të Frontit, ndërsa Mehmet Shehu la postin e sekretarit të PPSh[5] dhe të ministrit të brendshëm, dhe u bë kryeministër i një qeverie të përbërë jo më nga 18, por nga 9 ministra.

Në vitet e Detantës, Shqipëria përjetoi një hapje të politikës së saj të jashtme dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare. Që në takimin e parë në Moskë në qershor të v. 1953, Molotovi i konfirmoi Hoxhës se "deri tash mund të themi se çdo gjë është bërë në drejtim që të ashpërsohet sa më shumë situata me fqinjët tuaj. E di se keni vepruar në këshillim me ne, por këtej e tutje, edhe ne edhe ju, duhet të revizionojmë qëndrimet e jashtme. Detyra është të përmirësohen marrëdhëniet me fqinjët tuaj në Itali, Jugosllavi dhe Greqi".[6] Që në dhjetor 1953, qeveria shqiptare me porosi të Moskës i dërgon letër Sekretarit të Përgjithshëm të OKB për të ndërmjetësuar te qeveria greke për ndërtimin e piramidave, më pas ngrihet problemi i robërve grekë të luftës në Shqipëri dhe ai i marrëdhënieve diplomatike. Me Italinë përfundon Traktati i Paqes dhe nënshkruhen disa marrëveshje tregtare. Po kështu me Jugosllavinë, në nëntor 1953, qeveria shqiptare nën nxitjen e Moskës merr e para iniciativën për rihapjen e përfaqësive diplomatike respektive në Beograd dhe në Tiranë. Megjithatë duhet thënë se edhe gjatë Detantës, Shqipëria do të vazhdonte të mbetej një vend i kapur. Politika e brendshme do të ishte një kopje e modelit sovjetik, ku klasa politike do të përpiqej të mbante me çdo çmim pushtetin,

[4] *AQSh/AP*, Organet Udhëheqëse (më tej: O.U.), Fondi 14, viti 1953, dos. 23. Në këtë kohë Enver Hoxha mbante funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të PPSh, ministrit të Jashtëm, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Kryetarit të Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

[5] Në atë kohë, PPSh kishte katër sekretarë.

[6] *AQSh/AP*, O.U., Fondi 14, viti 1953, dos. 23.

ndërsa politika e jashtme për mirë apo për keq do të vihej në funksion të interesave strategjike të Moskës. Kështu, nëqoftëse politika e jashtme e Shqipërisë gjatë Detantës përjetoi një lloj hapjeje, sidomos me fqinjët, Greqi, Jugosllavi e Itali, kjo u bë me kërkesë të drejtpërdrejtë të Molotovit në qershor 1953, në Moskë. Por, nëse në vitin 1956, qeveria shqiptare përkrahu ndërhyrjen e tankeve sovjetike në Hungari, kjo u bë përsëri sipas urdhrit të Moskës.

Ndërsa vendet e Evropës Lindore po lironin burmat shtrënguese të dhunës masive dhe në rrugë të ndryshme përpiqeshin t'i shpëtonin kontrollit sovjetik, në Shqipëri, në këtë skaj jugperëndimor të Ballkanit, Enver Hoxha mundi të shfrytëzojë vijën dhe mbështetjen e BS për të rritur autoritetin e PPSh dhe gjithashtu kultin e tij. U krijuan organizatat e partisë në të gjitha strukturat shtetërore, në ministri, në ushtri, në institucionet kulturore e shkencore etj. Që në fjalimin e tij me rastin e emërimit të kryeministrit dhe të qeverisë së re, E. Hoxha theksoi se "nuk mund të ketë problem shtetëror që të vihet në jetë pa u vendosur në KQ dhe në Byronë Politike", një referencë kjo për kultin e Partisë, e tërthorazi dhe për kultin e tij. Ai manovroi me kujdes për t'i kundërbalancuar funksionet e shumta që mbante deri atëherë, me luftën që ai paskësh bërë duke kërkuar "t'i jepet fund njëherë e përgjithmonë manifestimeve të shfrenuara me emrin e tij, ngritjes së busteve të tij nëpër qytete, vënies pa rast dhe pa arsye të fotografive të tij në gazeta dhe revista dhe të tjera shfaqje të këtij lloji"[7]. Pas dy vjetësh, në konferencën e Tiranës në prill 1956, dhe më vonë, ai do t'i referohej këtij fragmenti duke e reklamuar atë si një provë të hershme e të fuqishme të luftës tij kundër kultit të individit, a thua se propaganda në Shqipëri bëhej individuale dhe jo e iniciuar apo e kontrolluar nga partia-shtet.

Se si luftoi E. Hoxha për të ruajtur kultin e tij edhe në kohën e Detantës, po përmend këtu rastin më tipik, dënimin e Tuk Jakovës, atë kohë, Zv/kryeministër dhe anëtar i KQ PPSh. Në prill të v. 1955, kur në një plenum partie diskutohej "për rolin e masave në histori", Tuk Jakova, pohoi me guxim se "në muze, ekspozita etj, historia e Partisë fillon vetëm me shtëpinë bosh ku u themelua Partia dhe ku ndodhet vetëm figura e shokut Enver me dy leje kalimi. Të jepet përshtypja sikur atë e ka formuar shoku Enver, gjë që nuk është e drejtë"[8]. Ai kërkoi që jo vetëm për krijimin e PKSh, por edhe për konferencën e Pezës, për mbledhjen e Labinotit, për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm etj., të vendoseshin emrat e delegatëve, të zgjedhurve në forume dhe kontributi që ata kishin dhënë për ngjarjen në fjalë. Me diskutimin e tij, Tuk Jakova kishte hedhur "bombën" në plenum. Në të gjitha librat, tekstet dhe propagandën e kohës, emri i Enver Hoxhës kishte marrë të drejtën e qytetarisë si themelues i PKSh. Veprimtaria e grupeve komuniste para krijimit të Partisë ishte nxirë,

[7] *Po aty*, O.U., Fondi 14, viti 1954, dos. 2.
[8] *Po aty*, O.U., Fondi 14, viti 1955, dos. 1.

ndërsa bashkëpunëtorët e tjerë që nuk i ishin nënshtruar shkopit dirigjues të Hoxhës, ishin goditur fort dhe zhdukur nga historia. Një iniciativë e vitit 1951 për të shkruar historinë e PPSh që nga krijimi i saj kishte dështuar, pasi aktorët e ngjarjeve që ishin ende gjallë kishin dëshmuar në kujtimet e tyre të shkruara një histori ndryshe nga ajo që popullarizohej.

Duhet shtuar se Tuk Jakova e shtriu arsyetimin e tij deri te ahistorizmi i Miladin Popoviçit. Duke evidencuar rolin mediator të Miladin Popoviçit në themelimin e PKSh, Tuk Jakova pohoi se në atë moment historik "autoriteti i shokëve shqiptarë nuk ishte i tillë që të dilte mbi grindjet e grupeve" dhe kërkoi që për këtë meritë, fotoja apo busti i Miladin Popoviçit të vendosej në muze.[9] Madje shtoi se nuk shihte "arsye politike" që të pengonte zgjidhjen e kësaj çështjeje.

"Arsyeja politike" ishte kursi i Hrushovit për afrimin e PKJ me Bllokun komunist, prej të cilit ajo ishte përjashtuar më 1948. Në kohën kur zhvillohej Plenumi (1955) kishte kaluar pothuajse një vit (qershor 1954), që udhëheqja shqiptare ishte informuar për hapat që po ndërmerrnin drejtuesit sovjetikë ndaj Jugosllavisë dhe i kishte miratuar publikisht ato. Pikërisht, duke u nisur nga këto rrethana të reja, Tuk Jakova mori guximin të pohonte më hapur një të vërtetë historike. Por kishte shkuar shumë larg. Diskutimet për rolin jothemelues të Enver Hoxhës në krijimin e PKSh ishin një temë tabu që nga kongresi i parë i PPSh, ku ishte dhënë një version i ndryshuar dhe i deformuar i këtij procesi. Reagimi i Enver Hoxhës ndaj diskutimit të Tuk Jakovës ishte i egër. Ai u etiketua si "konfuz", "revizionist", që donte "ta fuste partinë në qorrsokak", por gjithsesi në plenum nuk u mor asnjë masë dhe në Rezolucion nuk u tha asnjë fjalë për Tuk Jakovën.

Një muaj më pas (maj 1955), Hrushovi shkoi vetë në Beograd ku zhvilloi diskutime me Titon dhe sipas shembullit të Partisë mëmë sovjetike, edhe partitë e tjera komuniste të Bllokut filluan të marrin masat përkatëse për "të hedhur poshtë me vendosmëri të gjitha mbishtresat e formuara pas prerjes së marrëdhënieve normale mes tyre" dhe t'u japin fund organizimeve dhe veprimtarive antijugosllave. Nga ana e saj edhe Jugosllavia merrte masat e saj përkatëse. Dukej sikur koha punonte për Tuk Jakovën. Por jo kërkesa e tij për evidencimin e rolit të Miladin Popoviçit në historinë e PKSh nuk u konsiderua si një veprim në përputhje me frymën e mirëkuptimit me PKJ. Disa burime të tërthorta bëjnë me dije se për dënimin e Tuk Jakovës ka dhënë miratim vetë Hrushovi.[10] Por në kohën që në të gjithë vendet e Bllokut kishte filluar procesi i rehabilitimit të figurave të dënuara me akuzën "projugosllav", duket nonsens

[9] *Po aty*.

[10] Balazs Szalontai, "Ngjarjet përpara revolucionit hungarez të 1956 dhe rrethanat e tij ndërkombëtare". Kumtesë e mbajtur me rastin e 50-vjetorit të Revolucionit hungarez, në Tiranë, nëntor 2006.

një qëndrim i tillë. Nisur nga praktikat e mëparshme të luftës së nëndheshme për pushtet brenda udhëheqjes së PPSh, ekziston mundësia që Mehmet Shehu i cili takoi Hrushovin në Varshavë në maj 1955 (me rastin e nënshkrimit të Traktatit të Varshavës), të mos e ketë përmendur fare kërkesën e Tuk Jakovës për Miladin Popoviçin, por ta ketë vënë theksin në një fakt tjetër, në atë që ishte pikërisht Tuk Jakova ai që zëvendësoi Koçi Xoxen dhe që në Raportin organizativ që mbajti në kongresin e parë të PPSh e dënoi ashpër Xoxen, midis të tjerash edhe si agjent i jugosllavëve. Dënimi së bashku me Tuk Jakovën edhe i Bedri Spahiut, i cili ishte Prokuror i trupit gjykues që dënoi Koçi Xoxen në 1949, është një silogjizëm që e përforcon këtë konstatim. Kjo hipotezë përputhet edhe me praktikat që u zbatuan në vendet e Evropës Lindore e Qendrore, ku pas pajtimit me PKJ u shkarkuan ose u dënuan nga funksionet shumica e atyre që dikur kishin dhënë dënime për "ish agjentët jugosllavë". Tuk Jakova u dënua pak ditë pasi u kthye M. Shehu nga Varshava, në qershor 1955, duke u përjashtuar nga KQ dhe nga të gjitha postet shtetërore. Më vonë pasuan vitet e burgut. Vetëm kjo ishte rruga në të cilën mund të mbijetonte kulti i Hoxhës.

Gjatë viteve të Detantës, Enver Hoxha u tregua shumë i kujdesshëm për të qëndruar sa më pranë udhëheqjes sovjetike, për të ndjekur sa më afër ndryshimet në kupolën sovjetike të Bllokut komunist, për të joshur sovjetikët dhe për të ruajtur në mënyrë ortodokse pushtetin komunist në vend. Që në takimin e parë në vitin 1953, ai i kërkoi liderëve të rinj sovjetikë një traktat miqësie dhe ndihme reciproke Shqipëri-BS, më vonë, në vitin 1955 miratoi publikisht afrimin me Jugosllavinë dhe në vitin 1956 përshëndeti Kongresin e XX të PKBS. Në brendësi të kësaj fasade, në mbledhjen sekrete të Byrosë Politike, udhëheqja shqiptare shprehte tmerrin ndaj kërkesave të Hrushovit për shpërndarjen e Byrosë Informative, për marrëdhënie të afërta me "fashistin" Tito që u bë "shoku" Tito, për bashkekzistencën paqësore me imperializmin, për rehabilitimin e Koçi Xoxes, për dënimin e Stalinit etj. Udhëheqja shqiptare zgjodhi të ishte e dyzuar në politikën e saj, si e vetmja mënyrë për të siguruar mbijetesën në konjukturat e krijuara. Konferenca e Tiranës e prillit 1956, ku nga një anë mësimet e Kongresit të XX të PKBS propagandoheshin si udhërrëfyese dhe, nga ana tjetër u dhunua fjala e lirë duke shkarkuar nga funksionet, larguar nga puna, burgosur e internuar qindra vetë, është simbol i kësaj politike. Akoma më tej, Kongresi i III i PPSh, një muaj më vonë, në maj 1956, për të cilin delegati i Presidiumit të PKBS, Pospellov, u shpreh se "udhëheqja shqiptare është në rrugë të drejtë", i tregoi Enver Hoxhës se e rëndësishme për Hrushovin dhe drejtuesit e tjerë sovjetikë ishte që Shqipëria të mos bëhej shqetësim në planet strategjike të Bashkimit Sovjetik.

Duke kuptuar këtë filozofi, Hoxha gjatë gjithë Detantës vazhdoi të ndjekë brenda vendit, politikën e tij tradicionale të dorës së fortë, të kamufluar me

propagandën e kohës ose me disa veprime spektakolare, siç ishte p.sh amnistia, ku nga 5000 vetë që përfituan, vetëm 150 ishin të burgosur politikë. Ato që ngjanë në Gjermaninë Lindore (mars 1953), në Poloni dhe Hungari (tetor – nëntor të 1956), ku tanket sovjetike u vunë përballë dhe përgjakën revoltat masive qytetare, dhanë qartë mesazhin se BS nuk lejonte të prekej ngrehina komuniste e pas Luftës Dytë Botërore, por edhe Perëndimi, pavarësisht nga propaganda e tij për "çlirim" të këtyre vendeve, nuk kishte ndërmend të ndërhynte. Ky ishte një qëndrim i kodifikuar Lindje-Perëndim, karakteristik për Detantën e Parë, ku secila palë vazhdonte të mbronte sferat e veta të influencës, por në kushtet e një tensioni më të ulur. Paradoksialisht, qëndrimet e udhëheqësve të rinj sovjetikë, që u përpoqën të minimizojnë pakënaqësinë dhe urrejtjen që kishte shkaktuar politika staliniste brenda dhe jashtë BS, ngjalli shpërthime popullore në këto vende, që kërkonin një jetë më të mirë dhe më të çlirët nga BS. Ndërsa udhëheqësit komunistë më të ashpër stalinistë u treguan më të aftë të ruanin kontrollin ndaj reformave të pjesshme dhe ndaj nacionalizmit gjithnjë në rritje në vendet e tyre të kapura.